



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
KËSHILLI I BASHKISË DEVOLL

VENDIM

Nr 35 .Datë 30.01 .2023.

**PER MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE TE BASHKISE DEVOLL
PER VITIN 2024**

Bazuar ne Ligjin nr.9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore " i ndryshuar, ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore",ligji nr.9723 datë 03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit ",i ndryshuar, ligji nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. V.K.M nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë të paluajtshme ndërtesa,bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës , si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" i ndryshuar. Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të ardhurat " i ndryshuar, ligji nr.10081 datë 23.02.2006 "Për licencat,autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" Ligji nr.9975 datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" i ndryshuar. Ligji nr.9482 date 01.08.2006 "Për ligjin për bashkëpunimin dhe integrimin e ndërmjetve pa leje" i ndryshuar,ligji nr.107/2014 date 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Ligji nr.10465 datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,ligji nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative" Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve " i ndryshuar.V.K.M. nr.179 datë 09.03.2016 "Për miratimin e statutit të Qëndres kombëtare të Regjistrimit",V.K.M Nr.783 datë 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njesitë e qeverisjes vendore"i ndryshuar,V.K.M Nr.54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve,dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar.V.K.M Nr.559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim,perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike , si per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.V.K.M nr.285 datë 27.06.2002 "Për tarifatat e shërbimeve që kryen Policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave,juridike,fizike,vendas dhe të huaj" Ligjit nr.68/2017 datë 27.04.2017

“Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin nr.152/2015 date 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, Ligji nr.24/2017 “ Për administrimin e Ujitjes dhe Kullimit” , VKM nr.319 date 31.05.2018 (Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve).

Keshilli I Bashkise Devoll me 13 vota pro, 0 kunder , 0 abstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 sipas materialit bashkengjitur.
2. Te përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore ,vetem individi qe i perket ketyre shtresave shoqerore te meposhteme:
 - a. Invalidet e punes
 - b. Te verberit
 - c. Paaftesia
 - d. Paraplegjiket dhe Tetraplegjiket
3. Perjashtimin nga pagesa e taksave dhe tarifave te biznesit per vitin e pare per personat e komunitetit Rom dhe Egjiptian .
4. Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt shërbëhen.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha strukturat e Bashkisë Devoll qe preken nga paketa Fiskale .
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr.139/2015 datë17.12.2015 “Për vetqeverisjen Vendore”

KRYETARI I KËSHILLIT

GENTLLAKOLLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
KRYETARI

RELACION
MBI
PROJEKT VENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE TE BASHKISE DEVOLL PER
VITIN 2024”

I. Argumentim ligjor mbi natyren e aktit administrativ

Aktet administrative sipas natyres se aktit ndahen ne:

- 13) Akte administrative me karakter normativ
- 14) Akte administrative me karakter individual
- 15) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas percaktimit te nenit 13 pika 2 te ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, “Vendimet, urdherat, dhe urdheresat me karakter normativ te organeve te veteqeverisjes vendore i nenshtrohen verifikimit te ligjshmerise nga autoriteti i percaktuar ne ligj”

Po keshtu, ne ligjin 107/2016 “Per Prefektin” neni 4/i percakton: “Akte normative, jane aktet qe nxirren nga organet e qeverisjes vendore, sipas ligjit “Per veteqeverisjen vendore” dhe qe kane fuqi brenda juridiksionit territorial te tyre, qe i nenshtrihen verifikimit te ligjshmerise nga Prefektii qarkut, sipas ketij ligji”.

Me tej ky ligj ne nenin 8 shkronja “a” percakton se eshte pergjegjesi e prefektit, verifikimi i ligjshmerise se vendimeve, urdherave dhe urdheresave me karakter normativ te organeve te veteqeverisjes vendore”.

Nga sa me siper organet pergjegjese prane bashkise kane detyrimin e interpretimit te natyres normative te aktit administrativ, procedure e cila percakton nese akti administrativ qe do te miratohet ne Keshillin Bashkiak do te verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korce per perputhshmeri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, tëndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar ne ligjin 44/2015 “Kodi i Procedures Administrative” neni 3 pika 2 percakton si vijon:

“Akti normativ është cdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Administrative jep këtë përkufizim për aktin administrativ me karakter individual: “Akti administrativ individual është cdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundërt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”.

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të përcaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij projekt vendimi, gjykojmë se ai është një projekt vendim i cili plotëson elementet e përcaktuara në nenin 3 pika 2 të “Kodit të Procedurës Administrative” pasi është një akt i nxjerre nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili nuk është i shteruar në zbatimin e tij dhe që me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Devoll dhe kundërt një numri të përcaktuar subjektsh.

Gjate zbatimit të tij ky projektvendim shtrin efektet në të gjithë territorin e Bashkisë Devoll dhe në të gjithë qytetaret e Bashkisë Devoll të cilët paguajnë tarifën dhe taksat kundërt Bashkisë Devoll.

Perfundimisht, konkludojmë se akti administrative është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë, sipas ligjit.


Percaktoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik:

Përgjegjes i Sektorit Juridik

Eriksela AVDO

KRYETARI BASHKISË

Eduard DURO



Nr. 4246 Prot
Dg. 21.12.2023

red. Këshillit
of



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Nr. 1034/1 Prot.

Korçë, më 13.12.2023

Lënda: Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË DEVOLL

KRYETARIT TË BASHKISË DEVOLL

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të vendimeve nr. 80, nr. 81, nr. 82, nr. 83, nr. 84, nr. 85, nr. 86, nr. 88, nr. 91, nr. 92, nr. 93, nr. 94, nr. 95, datë 30.11.2023 të Këshillit të Bashkisë Devoll, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre**, bazuar në nenin 3, 8, 9, 25, 27, 28, 29, 34, 35, 40, 54, 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në nenin 801 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet", në ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 398, datë 13. 5. 2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", në udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Devoll, në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në nenin 30, pika gj e ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar, në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, në ligjin nr. 10 081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i

ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.179, datë 09.03.2016 “Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të regjistrimit”, në vendimin nr. 783, datë 10.11.2011, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e ndarjes të të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim, përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, në ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.

Shënim: Vendim nr. 285, datë 27.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj” është i shfuqizuar nga vendimi nr. 607, datë 29.7.2020 “Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar është shfuqizuar nga ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me vendimet nr. 87, nr. 89, nr. 90, datë 30.11.2023 të Këshillit të Bashkisë Devoll, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë konsideron që shqyrtimi i ligjshmërisë së tyre del jashtë kompetencave të dhëna me ligj, pasi aktet nuk plotësojnë kriteret e aktit administrativ normativ.

P R E F E K T I

N E R T I L J O E

